


DEMOKRACIA, SISTEM I VLERAVE



DEMOKRACIA SIGURON MIRËQENIEN PUBLIKE

ALMIR (12), LORENA (13), ALTIONA (12), DORELA (12), ENDRIT (13), ERBLIN (13), DRIARD (13)




A e dini se pse demokracia është sistem që ka sjellur mirëqenie, bashkëpunim, tolerancë, barazi në mes të qenieve njerëzore? Pse sistemi demokratik ndriçoi jetën tonë? Nëse jeni të interesuar t'i mësoni përgjigjet e këtyre pyetjeve, tregohuni të vëmendshëm dhe lexojeni artikullin më poshtë

A keni dëgjuar se më herët të drejtën e votës e kishin vetëm burrat e pasur? A keni dëgjuar për skllëverit dhe për shkeljen e të drejtave të njeriut? Të gjitha këto aplikoheshin në disa sisteme të tjera, në të cilat nuk kishte barazi, bashkëpunim dhe tolerancë ndaj njëritjetrit. Për këtë arsye, është shfaqur sistemi më i mirë

kracisë që Kosova ka është e njohur si demokraci përfaqësuese parlamentare. Kjo nënkupton se populli zgjedh deputetët, pastaj deputetët zgjedhin Qeverinë dhe Presidentin e vendit. Pra, fuqia i takon popullit. Këtë fuqi populli duhet ta shfrytëzojë sa më shumë, sepse përgjegjësia bie mbi ne në ndërtimin e mëtutjeshëm të demokracisë. Prandaj, iu bëjmë thirrje që edhe ju të filloni t'i zbatoni elementet e demokracisë, të cilat janë: barazia, toleranca, solidariteti, bashkëpunimi, shprehja e lirë, etj.

Ne e kuptuam rolin që kemi në një shtet demokratik dhe e kuptuam se vlera jonë është shumë e madhe. Veçse, duhet ditur se duhet të kontribuojmë dhe t'i zbatojmë parimet demokratike. Vetëm kështu jemi të lumtur të gjithë dhe kemi një të ardhme të ndritur.



Zhvillimi ndodh kur të gjithë kontribuojmë dhe japim më të mirën nga vetja jonë

i njohur si demokraci. Ky sistem siguron të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh moshën, gjininë, racën, fenë, etj. E pikërisht, kjo është arsyeja që demokracia na siguron mirëqenie sociale. Në demokraci, vullneti i popullit vendos gjithçka. Kjo i bie se vendimmarrja i takon popullit. Edhe shteti ynë Kosova ka demokraci dhe lloji i demo-



Ne jemi autorët e artikullit

PËRGJEGJËSIA QYTETARE NË DEMOKRACI

AURON (13), LEUNORA (13), ALTIN (13), EROLL (13), MIRNESA (13), DONART (13), ARIAN (13)

Të drejtat e qytetarëve në demokraci janë të domosdoshme, ashtu siç janë edhe përgjegjësitë tona

Java në të cilën jemi aktualisht, është java e fundit e vitit shkollor 2016-2017. Ashtu si qëndron qershia mbi tortë, edhe neve na është dhënë mundësia pikërisht në fund të këtij viti shkollor të jemi pjesë e Punëtorisë për Demokraci „Demos-ti“.

Këtu kemi marrë informata në lidhje me demokracinë dhe me qytetarinë aktive. Një qytetar që jeton në demokraci ka shumë të drejta të tilla, si: e drejta e votimit, e drejta e protestës, e drejta e fjalës së lirë, e drejta për të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme, e drejta e punësimit, shkollimit, etj. Por, të gjitha këto të drejta kanë edhe përgjegjësitë e tyre. Të drejtat dhe përgjegjësitë tona në një shtet demokratik, mund t'i paraqesim si në shembujt në vijim. Qytetarët mbi moshën 18 vjeçare, kanë të drejtë të votojnë, por gjithashtu kanë përgjegjësi të mos e keqpërdorim këtë të drejtë duke

votuar më shumë se një herë gjatë një procesi zgjedhor.

Ose rasti tjetër, kur neve nxënësve na lejohet të ushqehemi gjatë pushimit të gjatë në shkollë, por mbeturinat, siç janë letrat apo qeset e panevojshme nuk duhet t'i hedhim në ambientin e oborrit të shkollës, por t'i hedhim në vende të caktuara, siç janë shportat e mbeturinave.


Përgjegjësia qytetare, na bën neve të jemi aktiv kudo që ne ndodhemi. E kjo ndodh duke dalur në zgjedhje, duke marrë iniciativa qytetare për pastrimin e ambientit, duke marrë pjesë në tubime publike, etj. Ne, grupi që kemi diskutuar për qytetarinë aktive, kemi një porosi për lexuesit e artikullit tonë. Porosia jonë për ju është: që ta kemi të ardhmen e ndritur, bëhuni edhe ju qytetarë aktiv.



Barazia vlen për të gjithë



Bashkëpunues dhe solidarë me njëri-tjetrin



Sovraniteti në demokraci, ushtrohet përmes votës



Autorët e artikullit „Qytetaria Aktive“



Kuvendi i Kosovës mendon për të ardhmen tonë



Ne shkëlqejmë dhe rrezatojmë me parimet e demokracisë



Këtu kemi paraqitur disa kandidatë për deputetë



Vota juaj ka vlerë të madhe dhe ndikon në zhvillim



Të drejtat e mia mbrohen me Kushtetutë



Ne kemi të drejta, por kemi edhe përgjegjësi

KUVENDI - DIELLI YNË

ELIZA (12), ANJEZA (13), DAFINA (12), HANUMSHA (12), DREN (13), GETUAR (13), DAFINOR (12)



Kuvendi është institucion që na i përmbush nevojat dhe kërkesat tona si nxënës dhe si qytetarë. Për të kuptuar më mirë se si e bën këtë, ju ftojme të lexoni artikullin tonë, artikull i grupit „Margaritarët“

Të dashur bashkëmoshatarë, po e fillojmë këtë artikull me një fjalë të urtë shqipe „Kush punon, fiton“. Do të thotë, për të arritur diçka në të ardhmen, duhet të angazhohemi me punë në jetën e përditshme.

Ka mënyra të ndryshme se si mund të angazhohemi ne si nxënës. Për shembull, në garat e mbajtura nga „Kosovizion Contest“, klasa jonë ka arritur të shpërblehet. Kjo për shkak se projekti ynë është pëlqyer. Ne e kemi punuar këtë projekt me shumë përkushtim. Mirëpo, me parat që i fituam, investuam në blerjen e librave për bibliotekën e shkollës sonë. Gjithashtu, para këtij aktiviteti ne kemi bërë edhe një aktivitet ku kemi shitur ëmbëlsira. Parat e fituara nga aktiviteti në fjalë, na ndihmuan për realizimin e hapjes së bibliotekës. Kjo nënkupton se ne si qytetarë të demokracisë kemi shumë mënyra se si mund të jemi të dobishëm për vendin tonë dhe për qytetarët e tjerë. Gjithsesi, ne të gjithë meritojmë të jetojmë të lumtur dhe të sigurt. Por, a e dini se si mund të jemi të sigurt? Të sigurt ndihemi falë ligjeve. Ne e dijmë se ju lexues të nderuar keni dëgjuar për ligjet. Por, e dini se prej nga dalin ligjet? Ligjet dalin nga një institucion që quhet Kuvendi. Ky institucion është institucioni më i rëndësishëm demokratik. Miratimi i ligjeve është vetëm njëra nga detyrat që ka Kuvendi. Kjo detyrë, ndryshe njihet si funksioni legjislativ. Funksion tjetër i Kuvendit është funksioni kontrollues, sepse bën kontrollimin e punës

së Qeverisë. Ndërkaq, funksioni i tretë është funksioni përfaqësues. Kuvendi ka këtë funksion, sepse deputetët janë përfaqësuesit tanë. Meqenëse, ne si qytetarë jemi të shumtë në numër, nuk kemi mundësi të marrim vendime të gjithë së bashku dhe në të njëjtën kohë. E çfarë bëjmë atëherë? I zgjedhim pikërisht deputetët, të cilët me anë të votës tonë, i autorizojmë që të marrin vendime në emrin tonë. Gjithçka që ndodh në Kuvend, pa dyshim se e prek jetën tonë. Mund të pyesni pse? Ne mund t'ju përgjigjemi. Sepse fakti se në demokraci jemi të gjithë të barabartë, tregohet në shumë shkolla të Kosovës ku ka nxënës të komuniteteve jo shumicë që e vijnë mësimin, si të gjithë të tjerët. Kush e garanton këtë? Pikërisht ligji. Prandaj, ligjet që miratohen në Kuvend janë pjesë e jetës sonë. Kjo ishte e gjitha rreth Kuvendit dhe rëndësisë që ka ky institucion.



Margaritarët e bukur



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Naim Frashëri“
Klasa: VII-1
Vendi: Banjë, Malishevë